

**SPECIFIKIME TEKNIKE  
MBI PUNIMET NDERTIMORE**

**Objekti: "RIKONSTRUKSIONI I SPITALIT  
KUKES FAZA E DYTE"**

(Punime per pjesen teknologjike te fazes II te rikonstruksionit te sp.Kukes qe po  
implementohet nga Banka Boterore)

**POROSITËS**

**Spitali rajonal Kukes**

**PROJEKTUES**

**LENI-ING.shpk me Liçensë N. 2969/12**

**Tiranë 2021**

## NR. **PERSHKRIMI I PUNIMIT**

### I. **PUNIME DHERASH**

- 1 **Germim dhe zbankim dheu me makineri** Germim dhe themele ose për punime nentokesore, në thellesine të ndryshme nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thare ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjëve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,50 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve në lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në pergjithësi etj. si dhe spostimin brenda ambientit të kantierit dhe ngarkimin në makinerite e transportit.  
Zbankim dhe rrafshim dheu, i kryer me krah ose mjet mekanik, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, i thare ose i lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjëve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, duke përfshirë dhe plotësuar detyrimet në lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në pergjithësi etj., përfshirë spostimin brenda ambientit të kantierit dhe ngarkimin në makinerite e transportit.
- 2 **Germim dheu me krahe** Germim dheu themele ose për punime nentokesore, në thellesine të ndryshme nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thare ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjëve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,03 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve në lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në pergjithësi etj. si dhe spostimin brenda ambientit të kantierit me karro dore dhe ngarkimin me krahë në makinerite e transportit
- 3 **Mbushje ngjeshje dheu** Mbushjen me materialet e nxjerra nga germimi i dherave të themeleve, që do të kryhet për mbushjen e pjesve ansore të themeleve ose kanaleve si edhe për rastin e krijimit të shtresave në katin perdhe. Dherat e perdorura do të kontrollohen me pare nga Mbikqyresi dhe perdorimi i tyre do të autorizohet prej tij.
- 5 **Transport me auto evadim materialesh** Evadim me makineri transporti të çdo tonazhi të materialeve të krijuara nga germimi si dhe të materialeve të krijuara nga prishjet në godina ekzistuese.

### II. **PUNIME PRISHJEJE**

- 1 **Prishje murr tulle + transport me karro dore** Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, përfshirë dhe arkiturë apo breza lidhes betoni, e suvatuar ose jo, veshur me pllaka ose jo, e kryer me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellesie, përfshirë skelen e shërbimit ose skelerine, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat përreth, riparimi për demet e shkaktuara ndaj të treteve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujë, dritat etj.), spostimin e materialit brenda ambientit të kantierit ngarkimin e tij në makineri transporti si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund këtij procesi (prishjes).
- 2 **Prishje mur beton arme + transport me karro dore** Prishje totale ose e pjesshme e strukturave të betonit vertikale ose horizontale, me shume se 5 cm të trasha, prerjen e armaturës së hekurit duke përdorur çdo mjet, përfshirë puntelime, marrjen e masave për aplikimin e të gjithë akteve përkatëse të sigurisë së mbrojtjes së punetoreve brenda dhe jashtë kantierit, sinjalet e ditës e të natës si dhe personelin për lajmerimin e kalimtareve, punimet për rrethimet e perkohshme, riparimin për demet e mundshme që mund t'u shkaktohen të treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private, spostimin e materialit brenda ambientit të kantierit ngarkimin e tij në makineri transporti si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund këtij procesi (prishjes).
- 3 **Prishje shtrese betoni mbi dysheme 5cm + transport me karro dore** Prishje e dyshemeve të çfarëdo lloji, duke përfshirë thyerjen e betonit, shtresës mbushëse dhe spostimin e materialeve që rezultojnë, brenda ambientit të kantierit si dhe ngarkimin e tyre në makineri transporti.
- 4 **Heqje shtresë pllaka ekzistuese** Prishje e dyshemeve të çfarëdo lloji, duke përfshirë shkepjen e pllakave ekzistuese, shtresës së llaçit që ndodhet poshtë tyre, shtresës mbushëse dhe spostimin e materialeve që rezultojnë, brenda ambientit të kantierit si dhe ngarkimin e tyre në makineri transporti.
- 5 **Prishje shtrese hidroizolimi + transport me karro dore** Prishje e Shtresës horizontale të hidroizolimit të tarracës edhe me zhvillime vertikale (ane, tuba, oxhaqë) e ndertuar nga shtresa të mbivendosura leter katramaje, guajn duke përfshirë heqjen e kapakeve të parapetit e të çdo pjese metalike dhe venien menjane e spostimin në kantier të materialeve që formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund procesit si dhe ngarkimin e tyre me makineri transporti. Prishje e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guajnes së re.

**6 Prishje suvatimi (kollona, trare, tavan) + transport me karro dore**

Goditje e të gjithë siperfaqes se suvatuar dhe gjetje e pjesëve të mufatura dhe të plasaritura nepermjet tingullit, apo pjesëve gjometrikisht te pa pranueshme me shmangje nga plani vertikal apo horizontal(tavani) i suvase. Shmangje kemi atëhere kur një mastar 2m i gjate i vendosur në çfaredo drejtimi tregon "drite" mbi dy milimetra me siperfaqen e murit. Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e Llaçit që ndodhet poshte, pastrim, larje, prishjen e ketyre pjesëve deri në daljen e muraturës, në mure dhe tavane, larje e siperfaqeve të prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine, spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhenë plotesisht fund heqjes së suvasë.

**7 Prishje suvatimi të jashtëm**

Goditje e të gjithë siperfaqes se suvatuar dhe gjetje e pjesëve të mufatura dhe të plasaritura nepermjet tingullit, apo pjesëve gjometrikisht te pa pranueshme me shmangje nga plani vertikal i suvase. Shmangje kemi atëhere kur një mastar 2m i gjate i vendosur në çfaredo drejtimi tregon "drite" mbi dy milimetra me siperfaqen e murit. Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e Llaçit që ndodhet poshte, pastrim, larje, prishjen e ketyre pjesëve deri në daljen e muraturës, në mure dhe tavane, larje e siperfaqeve të prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine, spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhenë plotesisht fund heqjes së suvasë.

**8 Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme**

Heqje dyersh dhe dritaresh të çfarëdo lloji, perfshire kasen, telajot, etj., por me spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit të kantierit, duke perfshire perzgjedhjen e mundeshme (i percaktuar nga D.P.) dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

**9 Prishje dyer dritare te amortizuara ekzistuese**

Heqje dyersh dhe dritaresh të çfarëdo lloji, perfshire kasen, telajot, etj., por me spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit të kantierit, dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier si dhe ngarkimin e tij në makineri transporti.

**10 Heqje zgara dritare ekzistuese**

Heqje e zgarave të hekurit të çfarëdo lloji, por me spostimin e materialit qe rezulton, brenda ambientit të kantierit, duke perfshire perzgjedhjen e mundshme (të percaktuar nga investitori) dhe venien menjane në një vend të caktuar të kantierit për ripërdorim ose ngarkimin e tij në makineri transporti.

**III. PUNIME MURATURE. Të përgjithëshme**

**Mur tulle 25 cm, tulla teke te plota llaç M-75**

Murature me tulla të plota e ngritur me ose pa armatuarë në lartesi 3m, e formuar nga tulla të plota me trashësi 7 me Llaç M-75, duke perfshire çdo pune dhe detaj për dhembët e lidhjes, qoshet, parmaket, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo gje tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në menyre perfekte. Në rastin e mbylljes se dyerve rreshti i sipërm i muraturës të shrëngohet me pyka tulle të prera me gur fleksibël me nje kënd 20 gradë (afërsisht). Pykat të vendosen mbi çdo tullë pasi boshllëku midis saj dhe murit ekzistues sipër të jetë mbushur me llaç çimento. Të kihet kujdes lagja e mirë e murit ekzistues në rastin e lidhjes me të. Për muraturen e katit perdhe siperfaqja e themelit duhet të jete e niveluar me një shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

**Mur tulle 12 me tulla me vrima 12x25x25 llaç M-50**

Murature me tulla të lehtësuara, e ngritur me ose pa armatuarë në lartesi deri 4.5m, formuar nga tulla me vrima, me Llaç M-50, duke perfshire çdo pune dhe detaj për dhembët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo gje tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në menyre perfekte. Për muraturen e katit perdhe siperfaqja e themelit duhet të jete e niveluar me një Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

**3 Mur tulle 20 me tulla me vrima 20x25x25 llaç M-50**

Murature me tulla me 6 vrima, me trashesi 20 cm dhe Llaç M-50 perfshire çdo pune dhe detaj për dhembët e lidhjeve, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e sherbimit dhe çdo gje tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në menyre perfekte. Për muraturen e katit përdhe siperfaqja e themelit duhet të jetë e niveluar me një Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

**IV. PUNIME BETONI DHE KONSTRUKSIONI**

Beton marka 100 me zhavorr natyror: Çimento M-300 kg=240 , zhavorr m3=1,05, uje m3=0,19  
Beton marka 100 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento M-300 kg=240 , rërë e lare m3=0,45 , granil m3=0,70 , uje m3=0,19  
Beton marka 150 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento M-400 kg=260 , rërë e lare m3=0,44 , granil m3=0,70, uje m3=0,18.  
Beton marka 200 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento M-400 kg=300 , rërë e lare m3=0,43 , granil m3=0,69 , uje m3=0,18 .  
Beton marka 250 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento M-400 kg=370 , rërë e lare m3=0.43, granil m3=0,69 , uje m3=0,185 .  
Beton marka 300 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento M-400 kg=465 , rërë e lare m3=0,38 , granil m3=0,64 , uje m3=0,195 .

**1 Shtrese zhavori e ruluar**

Shtresë zhavori mbi terrenin e ngjeshur mire me parë ose mbi Shtresë kalldremi (sipas projektit), me zhavor lumi pa perberje argjilore ose çakull me trashësi të ndryshueshme sipas udhezimeve në projekt, e ngjeshur dhe e rrafshuar mire, e rulluar sipas udhëzimeve ne projekt.

## 2 **Shtrese zhavori e imët**

Shtresë zhavori me granulometri 10-20 mm mbi terrenin e ngjeshur mire me parë ose mbi Shtresë kalldremi (sipas projektit), me zhavor lumi të larë ose çakull me trashësi të ndryshueshme sipas udhezimeve në projekt, e ngjeshur dhe e rrafshuar mire.

## 3 **Mbushje me çakull për drenazhim**

Mbushje me çakull me granulometri të shkallëzuar ne shtrasa. Duke filluar me granulometri 100mm në shtresën e poshtëme deri ne granulometri 20mm ne pjesën e sipërme

## 4 **Shtrese betoni h=10cm M-150**

Shtresë betoni M-150, sipas pikes IV me lartësi 10cm sipas udhezimeve në projekt, i hedhur në vepër mbi një shtresë zhavori të ngjeshur mirë më parë, me një tolerancë në nivelim  $\pm 2\text{cm}$  në të gjithë objektin duke perfshire çdo detyrim tjetër për mbarimin e punes në menyre të rregullt.

## 5 **Beton M-200 per bordure dhe puseta**

puseta të parapregatitura ose të përgatitura në vend me armaturë dhe të vibruara mirë. Bordura të parapërgatitura ose të dedhura në vend me vibrim dhe me fuga mbi shtresat përkatëse sipas projektit

## 6 **Mure Pritës betoni M-200**

Mure betoni M-200 me beton të gatshëm ose të përgatitur në vend me vibrim dhe me tubat e drenazhimit sipas projektit si dhe çdo detyrim tjetër për trajtimin e betonit pas derdhjes. Lagie me uje të bollshëm çdo 6 orë për 28 ditë. Për temperatura mbi 30 gradë lagie çdo 3 orë në 7 ditët e para. Matje e markës në krye të 28 ditëve me çekiç. toleranca nga marka e kërkuar dhe nga kubikët e marë nga kampionet e derdhura në vepër jo më pak se 80% në mesatare të çdo 3 provave.

## 7 **Trarë themeli Beton-Arme M-250**

Trarë themeli Beton-Arme M-250 me beton të gatshëm ose të përgatitur në vend me vibrim me armaturë dërase në çdo faqe vertikale të tyre (betoni të mos këtë kontakt me dheun ne faqet anësore) lagie e mirë e shtresës niveluese të bërë më parë si dhe çdo detyrim tjetër për trajtimin e betonit pas derdhjes. Lagie me uje të bollshëm çdo 6 orë për 28 ditë. Për temperatura mbi 30 gradë lagie çdo 4 orë në 7 ditët e para. Matje e markës në krye të 7 ditëve me çekiç. toleranca nga marka e kërkuar jo më pak se 40% në mesatare të çdo 3 provave.

## 8 **Plinta Beton-Arme M-250**

Plinta Beton-Arme M-250 me beton të gatshëm ose të përgatitur në vend me vibrim me armaturë dërase në çdo faqe vertikale të tyre (betoni të mos këtë kontakt me dheun ne faqet anësore) lagie e mirë e shtresës niveluese të bërë më parë si dhe çdo detyrim tjetër për trajtimin e betonit pas derdhjes. Lagie me uje të bollshëm çdo 6 orë për 28 ditë. Për temperatura mbi 30 gradë lagie çdo 4 orë në 7 ditët e para. Matje e markës në krye të 7 ditëve me çekiç. toleranca nga marka e kërkuar 28 ditore jo më pak se 40% në mesatare të çdo 3 provave.

## 9 **Mure Beton-Arme M-250**

Mur beton-Arme M-250 me beton të gatshëm me granulometri variabël me vibrim me derdhje të pa ndërprerë me armaturë dërase ose panele, lagie e mirë e shtresës niveluese të bërë më parë, shmangje nga vertikalteteti jo me shume se 5mm në të gjithë sipërfaqen e murit si dhe çdo detyrim tjetër për trajtimin e betonit pas derdhjes. Lagie me uje të bollshëm çdo 6 orë për 28 ditë. Për temperatura mbi 30 gradë lagie çdo 3 orë në 7 ditët e para. Matje e markës në krye të 7 ditëve me çekiç. toleranca nga marka e kërkuar 28 ditore jo më pak se 45% në mesatare të çdo 3 provave.

## 10 **Kollona Beton-Arme M-250**

Kollona beton-Arme M-250 me beton të gatshëm me granulometri variabël me vibrim me derdhje të pa ndërprerë me armaturë dërase ose panele, çukitje e bazës së kollonës mbi themel ose mbi soletë, shmangje nga vertikalteteti jo me shume se 4mm në të gjithë lartësinë e kollonës si dhe çdo detyrim tjetër për trajtimin e betonit pas derdhjes. Lagie me uje të bollshëm çdo 6 orë për 28 ditë. Për temperatura mbi 30 gradë lagie çdo 3 orë në 7 ditët e para. Matje e markës në krye të 7 ditëve me çekiç. toleranca nga marka e kërkuar 28 ditore jo më pak se 45% në mesatare të çdo 3 provave.

## 11 **Trare Beton-Arme M-250**

Trarë betoni, të armuar në menyre të rregullt dhe sipas udhezimeve në projekt, i realizuar me betonin të dhene në vepër, i shtruar në shtresa të holla të vibruara mire, betoni M-250 me dozim sipas pikes 4.a.4, duke perfshire skelat e sherbimit, kallepet, perforcimet, hekurin e armatures si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punes në menyre perfekte. Arkitrarë në të gjithë gjerësinë e muraturës, me mbeshtetje prej 25 cm mbi shpatullat anësore, me lartësi të ndryshme sipas hapësires se drites, të armuar në menyren të rregullt dhe sipas udhezimeve në projekt, deri në lartësinë 2,5 metra, të formuar nga beton M-200 sipas pikes 4.a.4, duke perfshire skelat e sherbimit, kallepet perforcimet, hekurin e armatures dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punes në menyre perfekte.

## 12 **Solete monolite Beton-Arme M-250**

Soletë monolite betoni të armuar në menyre të rregullt, realizuar me beton M-200 sipas pikes 2.4 dhe sic tregohet në vizatime, e dhene në vepër në shtresa të holla të vibruara mire, duke perfshire hekurin, kallepet, puntelimet, perforcimet, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punes në menyre perfekte.

## 13 **Hekur betoni**

Punime hekuri për të gjithë elementet prej betoni të armuar qe prodhohen në kantjer, me hekur me karakteristika celik C-3 me  $R_a=2100 \text{ kg/cm}^2$ , në dimensione dhe forma sipas elementeve të projektuara në fletet përkatëse të projektit dhe sipas të gjitha kushteve teknike në fuqi si normativat e kthimit të ganxhave, të zgjatimeve për hekurit me permasa të gjate etj., për lende të pare (hekur) të shoqeruar me certifikatat e provave laboratorike për karakteristikat qe duhet të plotesoje, hekur pa perbajtje ndryshku duke perfshire çdo pune apo kerkese tjetër për ta konsideruar punimin e hekurit të perfunduar në menyre perfekte.

## V. **PUNIME RIFINITURE DHE SHTRESA**

### 1 Suvatime mure të brëndëshme

Sprucim i mureve me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjithjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund sprucimit. Sprucimi lihet te marre prezen per 24 ore duke e sperkatur me uje çdo 8 ore. Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm (astar) Llaçi m-25 me dozim për m<sup>2</sup> : rërë e lare m<sup>3</sup>=0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m<sup>3</sup>=0.03, çimento M-400 kg=6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf me fino të gateshme, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund suvatimit në menyre perfekte. Nderprerja e finos duhet te behet vetem në qoshe te mureve, pra një faqe muri e suvatuar me astar duhet te fillohet dhe te mbarohet pa nderprerje. Toleranca e lejuar nga vija e drejte per suvatimet është 1mm në dy metra gjatesi në çdo drejtim.

### 2 Suvatim mure të brëndëshme pa fino

Sprucim i mureve me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjithjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund sprucimit. Sprucimi lihet te marre prezen per 24 ore duke e sperkatur me uje çdo 8 ore. Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm (astar) Llaçi m-25 me dozim për m<sup>2</sup> : rërë e lare m<sup>3</sup>=0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m<sup>3</sup>=0.03, çimento M-400 kg=6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, e lënë grezo(pa fino), duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund suvatimit në menyre perfekte. Toleranca e lejuar nga vija e drejte per suvatimet është 3mm në dy metra gjatesi në çdo drejtim.

### 3 Suvatime tavani

Sprucim i tavaneve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjithjes së suvasë duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund sprucimit. Sprucimi lihet te marre prezen per 24 ore duke e sperkatur me uje çdo 8 ore. Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm (astar) Llaçi m-25 me dozim për m<sup>2</sup> : rërë e lare m<sup>3</sup>=0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m<sup>3</sup>=0.03, çimento M-400 kg=6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në tavan, dhe e lemuar me mistri e berdaf me fino të gateshme, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund suvatimit në menyre perfekte. Toleranca e lejuar nga vija e drejte per suvatimet është 1mm në dy metra gjatesi në çdo drejtim.

### 4 Suvatime te jashteme me fino te gateshme

Sprucim i mureve për murature, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjithjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund sprucimit. Sprucimi lihet te marre prezen per 24 ore duke e sperkatur me uje cdo 8 ore. Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim për m<sup>2</sup> : rërë e lare m<sup>3</sup>=0,005, Llaç bastard m<sup>3</sup>=0.03, çimento M-400 kg=7.7, uje, e aplikuar, në baze të drejtuesëve të përgatitura, në mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf me fino të gateshme, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhene plotësisht fund suvatimit në menyre perfekte. Shume rendesi ka përgatitja e drejtuesve me llaç te cilat vendosen në një plan per te gjithë faqen e godines. Nderprerja e finos duhet te behet në qoshe te mureve, ose me një kuote horizontale ku ka detaje te tjera si kuota e davancaleve, fundi i kornizve etj.

### 7 F.V. Mur me karton xhes dopjo shtresë me izolim termik akustik me trashësi 12.5cm.

Mur me dopio shtrese gipsi me profile vertikale me gjërësi 7.5cm shmangje nga vertikalteteti 2mm në të gjithë lartësinë e murit i mbërthyer mesatarisht me 24vida për m<sup>2</sup> mbi nje shtresë mbojtëse (sipas detajit) mbi dysheme me lidhje të pllakave me rjete përkatëse si dhe të qosheve të konkave (të lugëta) për mos plasaritje. Qoshet konvekse (të mysta) me profile metalike të rjetëzuar. Izolim me lesh xhami të fabrikuar me trashësi 8cm. Stukim (patinim) në të gjithë sipërfaqen me stuko përkatëse. Zmerilim i gjithë sipërfaqes si dhe çdo detyrim tjetër për të krijuar një sipërfaqe homogjene.

### 11 F.V. Tavan i varur me karton xhes me konstruksion dopjo, me dopio shtresë i matur ne projekcion horizontal I kombinuar me pllaka aluminate 60x60.

tavan i varur me dopio shtresë me gips nga 12.5mm seicila i mbërthyer me zgarë dopio në të dy drejtimet me mbërthime jo më pak se 90cm, me lidhje të pllakave të gipsit me rjete përkatëse si dhe të qosheve të konkave (të lugëta) për mos plasaritje. Qoshet konvekse (të mysta) me profile metalike të rjetëzuar. Stukim (patinim) në të gjithë sipërfaqen me stuko përkatëse. Zmerilim i gjithë sipërfaqes si dhe çdo detyrim tjetër për të krijuar një sipërfaqe homogjene. Pllaka aluminate të plastifikuara me modul 60x60 dhe të gjitha aksesorët e kapjes dhe montimit.

14 **F.V. Dysheme notuese me siperfaqe graniti dhe aksesore**

Dysheme notuese **jo e djegëshme, me rezistencë ndaj zjarrit 30minuta**, (që do të thotë që pllaka e dyshemesë të mbajë një pëshë të përqëndruar më mes të saj prej 70kG në një interval kohor 30 minuta minimumi) me lartësi të regjistrueshme me lartësi mesatare 35cm me regjistra vertikale (kolloneta) me interakse 60cm, me lidhëse (traversa) horizontale në formë "Ω" (omega) me h=38mm të cilat shërbejnë si mbështetese për pllakat horizontale sipër. Kolonetat ngjiten në dyshemenë e përfunduar me ngjitës poliuretani.

Pllakat të jenë të tipit kompozit me tre shtresa, siopas renditjes nga poshtë lart:

llamarinë e zinguar=0.5mm,

konglomerat materiali inert me bazë sulfat kalçiumi =12.5,

granit gri 12.5mm.

bymimi pas 24orë zhytje në ujë = 0.5%

Karakteristikat e Granitit

Përberja=artificiale e përbërë nga kokriza graniti natyral të përziera me rëshirë poliestere në masën 7% dhe e polimerizuar në të nxehtë.




Sipërfaqe = e luçiduar

trashësia = 10mm

Pesha = 25kG/m<sup>2</sup>

Rezistenca në shtypje = 1800kg/cm<sup>2</sup>

Në furnizimin e këtij zëri përmbidhen të gjithë aksesoret përsai përket bashkimeve me bazamakët e shkalleve, kollonat e betonit, si dhe korniza përmblyese në formë plintusi.



15 **F.V. Veshje shkalle me mermer Bezhe janine 3cm shkelje 2cm balli**

Veshje shkalle me mermer janine me preje sipas formave të dhëna në planimetri duke respektuar këndet e drejta me faqet e mureve, tolerancë 1mm nga këndet gjeometrike të dhëna në projekt. Shkelje e plotë e ballit 2cm mbi bazamakun e rradhës si dhe dhëmbi i bazamakut të dalë 1,5cm mbi ballin prej mermeri. pjertësi në drejtim të zbritjes 3% ose 1mm për copë. Shmangje nga plani i pjerrët i përbashkët i bazamakëve me 5mm. Zmusim me reze 1,5cm e dhëmbit të bazamakut.



**16 F.V. Plintuse shkalle me mermer 2cm**

Plintuse të vendosura mbi bazamak njësoj si shkallët, me lartësi sa një këmbë e plotë shkalle (17cm në rastine përgjithshëm) të vendosura rigorozisht në një plan (pavarësisht nga difektet që mund të ketë suvaja të lidhura me kollë mbi një sipërfaqe suvaje pa fino (finua të përfundohet pasi të vendosen plintuset). Të çukitet ose të priset suvaja kur është e nevojshme për të sjellë plintuset në një plan. Mbishkelja sa lartësia e bazamakut. (shih detajet)


**19 F.V. Kornizë travertine 5cm në dritare**

Kornizë travertine bezhë e vendosur në të gjithë perimetrin e dritareve, sipas detajit në projekt me pjese 100cm gjatesi të lidhura me kollë dhe me nga dy vida flutur për çdo pjesë mermeri të vendosura në vijë të drejtë dhe rigorozisht vertikale apo vertikale, kur në një ambient ka dy dritare njëra poshtë tjetrës skajet të jenë vertikalisht njëra sipër tjetrës me një shmangje më shumë se 3mm. korniza të jete pigul me sipërfaqen e xhamit me një shmangje të lejuar prej 2 mm nga plani pungul me faqen e xhamit.



**20 F.V. Davancale me mermer "bezhe janine" 3cm**

Davancalet e dritareve do të vendosen duke regullat e ristrukurimit të të gjithë fasadës. Gjate porosise se mermerit duhet të kihet parasysh që të buza e davancaleve të dale njesoj për të gjitha davanclet nga ana e fasades. Davancalet vendosen me pjertesë 1% nga ana e jashteme dhe buza e davancales të jete paralel me faqen e suvatimit nga jashte. Davancalet do të vendosen me kolle mbi një sipërfaqe grezo me llaç-çimento pasi të jete verifikuar kuota e kesaj sipërfaqeje në të gjithë fasaden me një proces verbal me një tolerance jo me shume se 5mm. Porosia e davancaleve të behet vetem pasi të jene mbaruar suvatimet e jashteme dhe të brendeshme si dhe shpatullat e dritareve.



**22 F.V. Plintuse të gatshme poçelangat idem me pllakat**

Xokol plintusi me ngjyre dhe tipologji si pllaka të shtreses, por jo me prerje të pllakave (i gatshëm), i zmusuar në pjesen e sipërme, i vendosur në vepër me kolle duke përfshirë stukimin me bojake, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote të punës në mënyrë perfekte. Vendosja e plintuesave behet në suva pa fino, njesoj si veshja me pllaka dhe para patinimit të mureve.

**24 F.V. Shtrim me pllaka poçelangat imitacion graniti me shkëlqim (ngjyra varion)**

Pllakat do të jenë të dimensiveve 31.6x31.6cm ose 40x40cm, gres porcelanato një brumeshe, jo luçidato, por me dizajno që të imitojë mermerin ose granitin, pra jo monokrome. Ngjyra e tyre të jete në bezhe ose oker. Pllakat do të jenë «zgjedhje e pare» të verifikuara në ambalazhim (në ambalazhin prej kartoni të çdo kutie me pllaka të shkruhet dukshëm në gjuhen perkatëse nga është importuar malli fjalet: "zgjedhje e pare" psh për një mall italian të shkruhet "schelta I"). Pllakat do të shrohen me kolle, mbi një sipërfaqe grezo me llaç-çimento pasi të jete verifikuar nivelimi i saj me një proces verbal. Nivelimi të behet nga një specialist topograf me një tolerance jo me shume se 5mm në të gjithë godinen. Pllakat do të shtrohen me fuga që formojnë një kënd 45 grade me akset e godines. Akset diagonale të pllakave duhet të jenë rigorozisht paralele me akset e godines dhe shtrimi i tyre duhet të jete pa ndërprerje nga koridori neper dhoma, pra fugat të jenë në vazhdimësi.

**25 F.V. Shtrim me pllaka porçelanat pa shkëlqim, imitacion graniti gri**

Pllakat do të jene të dimensineve 31.6x31.6cm ose 40x40cm, gres porcelanato një brumeshe, jo luçidato, por me dizeno qe të imitoje mermerin ose granitin, pra jo monokrome. Ngjyra e tyre të jete në bezhe ose oker. Pllakat do të jene «zgjedhje e pare» të verifikuara në ambalazhim (në ambalazhin prej kartoni te çdo kutie me pllaka te shkruhet dukshem në gjuhen perkatese nga është importuar malli fjalet: "zgjedhje e pare" psh per një mall italian te shkruhet "schelta I"). Pllakat do të shrohen me kolle, mbi një siperfaqe grezo me llaç-çimento pasi të jete verifikuar nivelimi i saj me një proces verbal. Nivelimi të behet nga një specialist topograf me një tolerance jo me shume se 5mm në të gjithë godinen. Akset e pllakave duhet të jene rigorozisht paralele me akset e godines dhe shtrimi i tyre duhet të jete pa nderprerje nga koridori neper dhoma, pra fugat të jene në vazhdimesi.



**27 F.V. Shtrim me pllaka graniti**

Shtim me pllaka graniti mbi një shtrese horizontale të ngjitura me kollë. Ky shtrim do të përdoret në ambientet më të rënësishme të godinës sipas sasivenë preventiv.



**28 F.V. Shtrim me pllaka porçelanat tualete**

Pllaka me ngjyrë homëgjene mbi një shtresë e bërë me pjerrësi për kullimin e ujrave sipërfaqësore drejt piletës. Mbishtresë hidroizoluese me asfalt të ftohtë dy duar. Pjerrësia me e vogël se 0.5%.

**33 F.V. Veshje me pllaka tualete**

Veshje për një lartësi 3 m të mureve, me pllaka majolike me dimensione 20x20cm ose 20x25 të cilesise se pare, vertetuar në ambalazhim, furnizuar dhe vendosur në vepër mbi një siperfaqen e pergatitur me pare me suva me astar pa fino dhe te ngjitura me kolle, stukim me bojake, me shmangje nga vertikalteteti 1mm për meter, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e veshjes në menyre perfekte. Te kihet parsysh vertikalteteti i suvase para fillimit te punes.

**VI. DYER DRITARE KANGJELLA QEPENA**

**6 F.V. Dere Duralumini me profil semi-struktural me ure termike me Xham Anti shok reshkitese me dy kanata me hapje me sensor ose automatike (P9)**

Derë me hapje automatike me kremalier automatik të montuar në soletën e katit me hapje me fotocelulë



12 **F.V. Dyer kundra zjarrit REI 60 (P6) (P7)**

shiko detajet në projekt doreza si në figurë



13 **F.V. Dyer Druri tamburato me Melamine (P13)**

shiko detajet në projekt

18 **F.V. Dritare duralumini me profil semi-struktural me ure termike me dopioxham**

shiko detajet në projekt

20 **F.V. Dritare fikse duralumini dopioxham**

shiko detajet në projekt

21 **F.V. Parapet duralumini me tuba dhe shufra + aksesore**

22 **F.V. Korimano Duralumini**

korimano e përshtatur sipas formes cilindrike të muraturës së betonit (me kalandrim) me ngjyrosje pas kalandrimit



**25 F.V. Ashensor kargo me nje piston hidraulik me kater ndalesa.**

Vendosje e ashensorit montim dhe garanci shërbimi dhe mirëmbajtje për 1 vit. Ashensor i mbështetur mbi një piston hidraulik në qëndër nga poshtë kabinës. Shkelja e ashensorit mund të jete metalike.

Përmasat e ashensorëve në projektin konstruktiv janë të vlefëshme vetëm si gabarite. Vendosja e ashensorëve, suporteve dhe shinave të saktësohen sipas markës së ashensorit që do të porositet. Marka dhe tipi i Ashensorit të Zgjidhen pas procesit të betonimit të struktures. Përmasat e kabinës të jenë të tilla që të lejojnë hyrjen lirisht të barelës me rota dhe të dy personave në këmbë.

Kabina të jetë me pasqyrë (anti klaustrofobike) pra sa e gjithë faqja përballë e kabinës. Me parapet të kromuar, me telefon me ventilim ndriçim 300lux, me panel elektronik me ekran LCD që informon për temperaturën katin. Ashensori të jetë me sistem elektronik të kontrollit të ndalimit dhe frenimit. Prodhuesi të jetë një shoqëri e njohur në tregun ndërkombëtar si OTIS apo Mitsubishi ..etj.



**VII. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE TARACE**

**1 Mbushje per termoizolim**

Formim i pjerresive mbi siperfaqen plane me një shtresë izoluesi termik me trashesi të ndryshme, për të patur një pjerresi sipas udhëzimeve në projekt, e realizuar me një perzierje me dozim për m<sup>3</sup>: çimento M-400 kg=280, rere shtufi e lare m<sup>3</sup>=0.15, poliesterol koker m<sup>3</sup>=0.88, e vene në vepër në shtresa duke formuar një masë unike.

**2 Shtrese lluster-çimento per nivelim 3cm**

Mbi pjerresine e pershkruar me siper, me trashesi minimale 2,5cm e realizuar me Llaç çimento 1:2, me dozim për m<sup>3</sup> sipas pikes 4.e, e niveluar në menyre perfekte për pergatitjen e siperfaqes mbi të cilen do të vihet hidro-izoluesi.

**3 Shtrese lluster çimento per mbrojtje hidroizolimi**

Llaç çimento 1:2 mbi shtresën hidroizoluese për siperfaqet e rrafshta, vertikale ose të pjerreta, me trashesi minimale prej 2.5cm dhe me fuga çdo 2 m, të mbushura me perzierje rërë dhe bitumi dhe çdo gje tjeter të nevojshme për të kryer punes dhe për ta realizuar ate në menyre perfekte.

**5 Hidroizolim me nje shtrese guajno mbi karton cimentato**

Mbi siperfaqe të thare dhe të niveluar si me siper, duke perfshire pjesen vertikale, trajtuar me një dore praimer me dozim 0.5kg/m<sup>2</sup>, e perbërë nga dy membrana guaine e perforuar seicila me një rrjete poliester, me trashesi 4mm secila, shtresa e sipërme të jete e trajtuar me granil të imet, të vendosura në vepër me flake dhe të kryqezuara, mbi siperfaqe të rrafshet, të pjerret ose vertikale, deri poshte impluves, si dhe çdo detyrim tjeter të nevojshem për të kryer punen në menyre perfekte.

**9 F.V. Ulluke Vertikal Plastik seksion  
drejtëndesh 10x6cm**

Ulluket vertikale për shkarkimin e ujrave të çatave dhe tarracave në gjendje jo të mire duhet të cmontohen dhe të zevendesohen me ulluke të rinj. Ulluke vertikale për shkarkimin e ujrave të tarracës i perbere me plastike me dimensione 5x10. Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe të çatise ose tarracës jo më të madhe se 50 m<sup>2</sup>. Ulluket duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës me anë të qaforeve përkatëse prej celiku të xinguar, të fiksuar mbi parete çdo 2m. Ujrat e tarracës duhet të mblidhen nepermjet një pjate plastike (prodhim i gatshëm), të vendosur në mënyrë të terthorë ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, dhe sipas udhëzimeve në projekt. Pjesa fundore e ullukeve, për lartëhet të kalojë nën trotuar dhe të derdhet në faqe të trotuarit. Gryka e ullkut duhet të betonohet me bordurën e trotuarit.